



Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute

www.kdi-kosova.org

Analizë Krahasuese

**Legjislacioni për Deklarimin, Prejardhjen, dhe
Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë
(Shqipëri, Maqedoni, Kroaci dhe Kosovë)**

Comparative analyse

**The legislation for Disclosure, Origin and Control
of assets of senior public officials
(Albania, Macedonia, Croatia and Kosovo)**

PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*
 Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*
 Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*
 Arsim GJINOVCI - *IT & design*

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*
 Esat MAZREKU - *Koordinator*

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Valmir ISMAILI - *Menaxher programi*
 Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*
 Isuf ZEJNA - *Monitorues*
 Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*
 Liridon SELMANI - *Monitorues*

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - *Koordinator*
 Ramadan KLISURICA - *Koordinator*

This publication was made possible through support provided by U.S. Agency for International Development Mission in Kosovo under the terms of Award Number: 167-A-00-00108-00-NAP05-2009.

The opinions expressed herein are those of the author and do not necessarily reflect the views of the U.S. Agency for International Development (USAID).

Ky publikim është realizuar me mbështetje të siguruar nga Agjencioni i SHBA-s për Misionin Ndërkombëtar për Zhvillim në Kosovë nën kushtet e Numrit të grantit: 167-A-00-00108-00-NAP05-2009.

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorit dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Prishtinë, Prill 2010

Përmbajtja

1. Hyrje.....	5
2. Republika e Shqipërisë.....	6
2.1 Korniza Ligjore.....	6
a). Subjektet e detyruara për të deklaruar pasurinë.....	6
b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara.....	8
c). Sanksionet.....	8
d). Deklarimi i rremë.....	9
e). Publikimi.....	9
2.2 Legjislacioni shtesë - ndihmës.....	9
3. Republika e Kroacisë.....	10
4.1 Korniza Ligjore.....	10
a) Subjektet e detyruara për të deklaruar pasurinë.....	10
b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara.....	11
c). Sanksionet.....	11
d). Publikimi.....	11
4. Republika e Maqedonisë	12
4.1 Korniza Ligjore.....	12
a). Subjektet e detyruara për ta deklaruar pasurinë.....	12
b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara.....	12
c). Sanksionet.....	13
d). Publikimi.....	13
5. Republika e Kosovës.....	14
5.1 Korniza Ligjore.....	14
a). Subjektet e detyruara për ta deklaruar pasurinë.....	15
b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara.....	15
c). Sanksionet.....	16
d). Publikimi.....	16
6. Përfundime.....	17
Bibliografia.....	18

1. Hyrje

Ky studim është realizuar si pjesë e projektit “Bazë Ligjore dhe Mekanizma Funkcional për Qeverisje të Mirë”, realizuar nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), dhe në partneritet me organizatën Lëvizja FOL. Projekti është përkrahur nga USAID dhe Institutit për Komunitete të Qëndrueshme (ISC) përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që: “të ndikoj në ndërtimin dhe implementimin e bazës ligjore, bazuar në principe të një shoqërie demokratike ku sundon ligji dhe masat anti-korruptive për një qeverisje të përgjegjshme llogaridhënëse, transparente dhe në shërbim të qytetarë ve.

Duke pas parasysh këtë qëllim, ky studim është koncentruar në bazën ligjore dhe në praktikën e disa vendeve të rajonit duke përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë, Kroacinë dhe Kosovën, duke ofruar një pasqyrë mbi përpjekjet e këtyre vendeve për të rregulluar me norma ligjore kontrollin publik të pasurisë, të hyrat dhe përfitimet e tjera materiale, detyrimet financiare nga zyrtarët publikë, familjarët e tyre dhe personat e lidhur me ta, përfshirë edhe sanksionet e përcaktuara me ligjet përkatëse.

Demokracitë e konsoliduar si një nga format më efikase të luftimit të fenomenit të korrupsionit e konsiderojnë bërjen publike dhe të qasshme për qytetarët pasurinë e zyrtarëve të lartë.

Ky studim ka për qëllim që të vë në pah krahasimet e legjislacionit që e mbulon këtë fushë në vendet e rajonit, në përkushtimin dhe detyrimet e tyre për t’i bërë publike pasurinë e zyrtarëve të lartë të zgjedhur si një nga parakushtet për luftimin e korrupsionit dhe i cili do të ndikonte në shtimin e besimit të përgjithshëm të qytetarëve tek bartësit e institucioneve publike.

Studimi është përqendruar në analizën e disa shtyllave duke u nisur nga organi përgjegjës që do ta mbikëqyrë dhe e zbaton procesin e deklarimit të pasurisë, subjektet të cilat kanë për detyrë për ta deklaruar pasurinë, përcaktimi me ligj nëse janë transparente dhe të qasshme për publikun të dhënat statistikore mbi gjendjen e deklaruar të pasurisë së zyrtarëve të lartë, verifikimin e pasurisë së deklaruar si dhe në fund masat dhe sanksionet që duhet të ndërmerren ndaj atyre zyrtarëve të cilët nuk pranojnë të deklarojnë pasurinë apo në rastin më të keq bëjnë edhe deklaram të rrejshëm të gjendjes së tyre pasurore.

Në pjesën e fundit të studimit është bërë krahasimi i dallimeve në mes legjislacionit të vendeve të rajonit dhe Kosovës në rregullimin ligjor të kësaj problematike.

Në mënyrë të përgjithshme mund të konstatohet se legjislacioni që e normon këtë fushë pothuaj në të gjitha vendet e rajonit janë të një standardi afërsisht të njëjtë me përjashtim të masave ndëshkuese (sanksioneve) që duhet të aplikohen ndaj zyrtarëve të lartë publik si subjekte të përcaktuar me dispozita ligjore të obliguar për ta bërë një gjë të tillë.

2. Republika e Shqipërisë

2.1 Korniza Ligjore

Republika e Shqipërisë këtë materie shumë të rëndësishme që do të ndikonte në uljen dhe parandalimin e fenomenit të korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës publike, e ka të rregulluar me Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë dhe me Ligjin Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike si dhe me disa ligje shtesë.

Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me 10.04.2003 i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta¹.

Organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive në Republikën e Shqipërisë është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive - Inspektori i Përgjithshëm i cili zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit, ndërmjet dy kandidaturave, për një mandat 5-vjeçar.

a). Subjektet e detyruara për të deklaruar pasurinë

Neni 3 i këtij ligji përcakton qartë subjektet që bartin detyrimin për deklarim të pasurisë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të cilët janë. Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat; nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive, të njëjstive bashkiake dhe të komunave; drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror; prokurorët, gjyqtarët dhe përmbaruesit e të gjitha niveleve; drejtuesit e institucioneve të pavarura publike; drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e rajone, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave; drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë; drejtuesit e të gjitha niveleve të KRRT-ve; zyrtarët që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, personat e barazuar me ta dhe drejtuesit e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe mesatarisht me më shumë se 50 punëtorë².

¹, Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë, <http://www.hidaa.gov.al/legjislacioni.html>, qasur me 10 prill 2010.

²Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë, neni 3, f -2, <http://www.hidaa.gov.al/legjislacioni.html>

Megjithatë përpos këtyre kategorive, me ligj i është garantuar Kuvendit të Shqipërisë e drejta, që pas propozimit të Inspektorit të Përgjithshëm, të vendos detyrimin për deklarim të pasurisë për funksionarë tjerë të cilët nuk janë parashikuara në këtë ligj.

Deklarimi i pasurisë përveç subjekteve të lartpërmendur është i obliguar edhe për anëtarët e familjes së tyre (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Gjithashtu ligji i mundëson deklaruesve, që përpara deklarimit, duhet t'i jepen të gjitha këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës dhe t'i bëhen të njohura pasojat që mbart deklarimi i rremë.

Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë i ka të përcaktuar edhe afatet kohore për subjektet e lartpërmendura që janë të detyruara ta bëjnë deklarimin e pasurisë pranë organit përgjegjës – Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Ligji në fjalë i obligon subjektet e detyruara që brenda datës 31 mars të çdo viti ta deklarojnë gjendjen e tyre të pasurisë deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare të cilat janë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publik; c) gjërat me vlerë të veçantë mbi 5 000 dollarë amerikanë; ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim; d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale; ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.

Zyrtarët të sapoemëruar në detyrë, të cilët ligji i ka paraparë si subjekte që janë të detyruar ta deklarojnë pasurinë, duhet që brenda 30 ditëve nga data e emërimit të plotësojnë dokumentin zyrtar, “Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës”, duke pasqyruar në të, të gjitha interesat private që ekzistojnë për vete, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë deri në ditën e fillimit të detyrës.

Zyrtarët të cilët kanë obligimin për deklarim, duhet brenda datës 31 mars të çdo viti detyrohen të paraqesin dokumentin zyrtar - deklaratën e interesave private periodik/vjetor. Kjo kategori e subjekteve janë të obliguar t'i raportojnë para organit kompetent vetëm ndryshimet e ndodhura në interesat private të deklaruara më parë, interesat e lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi.

Zyrtarët, të cilët janë larguar nga detyra, ndërsa me ligj kanë qenë subjekte të obliguar për raportim, duhet brenda 15 ditëve nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare të plotësojnë dokumentin zyrtar, "Deklaratë e interesave private pas largimit", duke pasqyruar në të vetëm interesat private të shtuara ose të pakësuara nga deklarimi i mëparshëm deri në datën e largimit nga funksioni për vete, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë deri në ditën e largimit nga detyra.

b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara

Verifikimi apo saktësimi i të dhënave të deklaruara është e rregulluar me nenin 7 të Ligjit për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë ku thuhet se: "Inspektori i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë deklarimin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të urdhërojë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarimeve edhe për personat fizikë e juridikë, kur, nga verifikimet e kryera, rezulton se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim"³.

Verifikimi i të dhënave të deklaruara bëhet sipas Ligjit Për Parandalimin e Konfliktit dhe të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike përkatësisht nenin 17 dhe 18 ku afatet kohore ndryshojnë në disa kategori. Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratë kryhet në disa afate kohore të rregullta, për kategorinë e zyrtarëve më të lartë publik (Presidenti, Kryeministri, ministrat, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit) verifikimi bëhet çdo dy vjet, për kategorinë tjetër (kryetarët e bashkive ose të komunave me mbi 10000 banorë dhe për kryetarët e këshillave të qarqeve) verifikimi bëhet çdo tre vjet dhe për kategorinë (deputetët, për titullarët e institucioneve shtetërore, qendrore ose vendore, dhe anëtarët e organeve kolegjiale të këtyre institucioneve) verifikimi i deklaratës së pasurisë bëhet çdo katër vite.

c). Sanksionet

Çështja e masave dhe sanksioneve ndaj subjekteve të cilat nuk e kryejnë obligimin e tyre ligjor për të deklaruar raportet periodike të gjendjes së tyre financiare është e rregulluar po ashtu me Ligjin Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike përkatësisht me nenin 44 pika c e këtij ligji ku shprehimisht thuhet: "Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë; ndërsa vazhdohet në pikën c ku thuhet: për mos deklarim periodik në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 20000 (njëzet mijë) lekë deri në 30000 (tridhjetë mijë) lekë"⁴.

³Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë f.3, <http://www.hidaa.gov.al/legjislacioni.html>

⁴Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, <http://www.hidaa.gov.al/legjislacioni.html>

Po ashtu Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë në nenin 5 flet për subjektet të cilët refuzojnë ta bëjnë deklarimin e ka paraparë masa mjaft të ashpra si: Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. Inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë. Organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarimin.

Në rastet kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, Inspektori i Përgjithshëm vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit.

d). Deklarimi i rremë

Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

e). Publikimi

Të dhënat që përfitohen nga deklarimi sipas këtij ligji janë të lejueshme për publikun, në përputhje me Ligjin "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

2.2 Legjislacioni shtesë - ndihmës

Ligjet shtesë të cilat në një formë apo tjetër ndikojnë në rregullimin ligjor të kësaj çështjeje janë: Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike, Ligji për Statusin e Nëpunësit Publik, Ligji mbi të Drejtën e Informimit, Ligji mbi Kodin e Procedurës Administrative, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

3. Republika e Kroacisë

4.1 Korniza Ligjore

Republika e Kroacisë materien që ka të bëjë me kontrollin publik të pasurisë, të hyrat dhe përfitimet e tjera materiale si dhe çështjen e parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, e ka të rregulluar përmes Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Komisioni për Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit. Ky komision përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve të cilët vetë e zgjedhin një kryetar. Anëtarët e komisionit emërohen nga parlamenti kroat me propozim të komisionit për zgjedhjet, emërimet dhe çështjet administrative. Mandati i anëtarëve të komisionit duhet të jetë shtatëvjeçar.

a) Subjektet e detyruara për të deklaruar pasurinë

Lista e zyrtarëve të cilët janë të përfshirë në ligj si subjekte që janë të detyruar ta deklarojnë pasurinë janë: kryetari i shtetit; deputetët e kuvendit të Kroacisë; kryeministri dhe anëtarët qeverisë; kryetari dhe anëtarët qe gjykatës kushtetuese; guvernatori dhe zëvendës (zv.) Guvernatorët e bankës kombëtare; auditori gjeneral dhe zv. auditorët; avokati e popullit dhe zv e tij; sekretari i kuvendit; sekretari i qeverise; sekretari i Gjykatës kushtetuese; sekretari i gjykatës supreme; zv sekretari i kuvendit dhe qeverise; sekretarët shtetëror; zv ministrat; asistentët e ministrave; sekretarët e ministrive; udhëheqësit, zv udhëheqësit dhe asistentët e organizatave administrative shtetërore; kryetari dhe zv kryetari i fondit të privatizimit; udhëheqësi dhe asistentët e udhëheqësit të fondit të sigurimit pensional; drejtori , zv drejtori dhe asistentët e drejtorit të fondit të sigurimit shëndetësor; Rektori dhe prorektorët; Drejtori i thesarit të shtetit; Inspektori i përgjithshëm Inspektoratit të shtetit, zv dhe asistentët e tij; Udhëheqësit e zyrave, agjencive dhe drejtorateve të qeverisë së Kroacisë, si dhe udhëheqësit e instituteve të të emëruara nga qeveria e Kroacisë; Zyrtarët në zyrën e presidentit të emëruar nga presidenti në pajtim me dispozitat e ligjit të veçantë; Shefi i forcave të armatosura dhe zv shefi; Shefi i Inspektoratit të mbrojtjes dhe zv i tij; Komandantët dhe zv komandantët e njësive të forcave të armatosura; Shefat e korpuseve të forcave të armatosura të Republikës së Kroacisë; Gjeneralët dhe Majorët; Kryetari i komunës së Zagrebit dhe Kryetarët e qarqeve⁵.

Ligji në fjalë përkatësisht neni 7 i tij parasheh formën e raportimit të pasurisë së zyrtarëve në Kroaci. Sipas këtij neni, brenda 30 ditësh nga marrja e postit, zyrtarët duhet të ofrojnë një raport me të dhëna për pronat e tyre, të hyrat e përhershme apo të pritura, pasurinë e gruas dhe fëmijëve të tyre, me bilancin e asaj kohe kur bëhet deklarimi, dhe po ashtu duhet të ofrojnë një raport me rastin e përfundimit të mandatit të tyre, si dhe me mbarimin e vitit gjatë ushtrimit të mandatit kur ndodh ndonjë ndryshim madhor.

⁵ Zakon o sprječavanju sukoba interesa u obnašanju javnih dužnost (Croatia). <http://lokalniiizbori.com/zakoni/zakon-o-sprjecavanju-sukoba-interesa-u-obnasanju-javnih-duznosti/>, qasur me: 06 prill 2010

Raporti që duhet të paraqesin zyrtarët duhet të përfshijnë të dhënat në lidhje me kursimet monetare nëse ato e kalojnë shumën e rrogës vjetore neto të zyrtarit.

b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara

Legjislacioni aktual në Republikën e Kroacisë nuk e ka paraparë në dispozitat e tij çështjen e verifikimit të pasurisë së deklaruar dhe institucionin që do të duhej të ishte përgjegjës për ta bërë një gjë të tillë.

c). Sanksionet

Ligji mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, përkatësisht neni 19 i ka përcaktuar sanksionet që mund të ndërmerren ndaj zyrtarëve që nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji mbi deklarimin e pasurisë. Sipas këtij neni, “zyrtarët, me ftesën e Komisionit, për format më të rënda të shkeljes së këtij ligji duhet të ofrojnë dorëheqjen tek organi që i ka emëruar ata”. Më pas vazhdon paragrafi 2 i nenit “Komisioni, ndaj një zyrtari mund të vendosë sanksionet në vijim: ndalesën e një pjese të rrogës neto mujore, paralajmërimin apo edhe publikimin e vendimit të Komisionit në llogari të zyrtarit”⁶.

Komisioni mund të vendosë dënime ndaj zyrtarit që nuk e dorëzon raportin sipas Nenit 7 të këtij ligji, apo jep të dhëna fallso në raportin e dorëzuar, duke ja ndaluar një pjesë të rrogës neto që sillet rreth 3,000,00 deri në 5,000,00 kuna.

Sanksionet që përfshijnë ndalesën e rrogës neto të një zyrtari nuk mund të aplikohen me shumë sesa 3 muaj, dhe shuma e përgjithshme e mbuluar nga kjo ndalesë nuk mund të kalojë me shumë 8,000 kuna⁷.

Komisioni mund të lëshojë një dënim ndaj një zyrtari në vend që të ndalojë pjesë të rrogës neto të tij në rastet e rrethanave lehtësuese. Komisioni mund të urdhërojë që vendimi për gjetjen e fajësisë së zyrtarit të publikohet në llogari të zyrtarit.

d). Publikimi

Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë duhet të jetë një dokument publik.

⁶ Zakon o sprječavanju sukoba interesa u obnašanju javnih dužnost (Croatia). <http://lokalniizbori.com/zakoni/zakon-o-sprjecavanju-sukoba-interesa-u-obnasanju-javnih-duznosti/>, qasur me: 06 prill 2010

⁷ Zakon o sprječavanju sukoba interesa u obnašanju javnih dužnost (Croatia). http://lokalniizbori.com/zakoni/zakon-o-sprjecavanju-sukoba-interesa-u-obnasanju-javnih-duznosti, qasur me: 06 prill 2010

4. Republika e Maqedonisë

4.1 Korniza Ligjore

Republika e Maqedonisë çështjen e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë e ka të rregulluar me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit i publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë me 26 prill 2002 si dhe i amendamentuar me 1 dhjetor 2006 dhe 16 janar 2008.

Organi përgjegjës i cili administron dhe mirëmban regjistrin me të dhënat e deklaruara nga subjektet detyruese me Ligj është Komisioni Kombëtar për Parandalimin e Korrupsionit. Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë që emërohen nga Kuvendi i Maqedonisë me mandat pesë vjeçar pa mundësi ri-emërimi. Në mes tjerash, në juridiksionin e këtij komisioni është edhe “evidencimi dhe ndjekja e situatës pronësore, ndryshimeve dhe aktiviteteve tjera fitimprurëse të zyrtarëve të zgjedhur, shërbyesve civil të emëruar, zyrtarëve dhe personave përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe personave tjerë juridik që menaxhojnë kapital shtetëror në mënyrën siç është definuar me këtë ligj”⁸.

a). *Subjektet e detyruara për ta deklaruar pasurinë*

Sipas dispozitave të këtij ligji, me zyrtarë apo subjektet që obligohen për të raportuar nënkuptohen: Presidenti i vendit, deputetët, kryetarët e komunave, ambasadorët dhe personeli tjetër i emëruar jashtë vendit, personat e zgjedhur apo të emëruar në dhe nga Kuvendi dhe qeveria e republikës, autoritetet e administratës shtetërore dhe autoritetet tjera shtetërore, autoritetet gjyqësore, ndërmarrjet publike, institucionet, entitetet tjera legale të qeverisë qendrore dhe autoriteteve lokale, shërbyesit civil dhe të punësuarit në administratën shtetërore dhe autoritete tjera shtetërore, autoritete gjyqësore, ndërmarrjet publike, institucionet dhe entitetet tjera legale të qeverisë qendrore dhe lokale, këshilltarët komunal në kuvendet komunale, sikurse edhe personat e punësuar përmes agjencive për punësim të përkohshëm me autorizim të specifikuar me ligj⁹.

Neni 33 i këtij ligji i obligon zyrtarët e shpërmendur që brenda 30 ditësh nga marrja e postit të deklarojnë pasurinë e tyre. Ata po ashtu brenda 30 ditësh nga marrja e postit duhet të heqin dorë nga sekreti i llogarisë së tyre bankare, qofshin ato brenda apo jashtë vendit. Të dyja këto dorëzohen tek Komisioni Shtetëror dhe Administrata e të Hyrave Publike.

b). *Verifikimi i të dhënave të deklaruara*

Çdo rritje e pronës së zyrtarëve publik apo të anëtarëve të familjes së tij, që i kalon

⁸ Law on Prevention of Corruption in Macedonia <http://www.dksk.org.mk/en/images/stories/law%20on%20prevention%20of%20corruption%20with%20amendments.pdf>, qasur me: 06 prill 2010

⁹ Law on Prevention of Corruption in Macedonia <http://www.dksk.org.mk/en/images/stories/law%20on%20prevention%20of%20corruption%20with%20amendments.pdf>, qasur me: 06 prill 2010

shumën e 20 rrogave mesatare në ekonominë vendore në tre muajt e fundit, po ashtu duhet të raportohet. Nëse zyrtari nuk vepron në bazë të dispozitave të para-para, atëherë mund të iniciohet ekzaminimi i pronës dhe gjendjes pronësore të zyrtarit në fjalë.

c). Sanksionet

Fillimi i procedurës për përgjegjësi kundërvajtëse iniciohet nga Administrata e të Hyrave Publike, pasi që të lajmëroj zyrtarin në fjalë për fillimin e procedurës¹⁰.

Kërkesë për fillim të procedurës po ashtu mund të bëhet edhe nga Komisioni Kombëtar. Përveç inicimit të procedurës, Administrata e të Hyrave Shtetërore dërgon edhe një propozim të gjykata themelore përkatëse për masa të përkohshme për t'ia ndaluar atij/asaj me disponim të pronës.

Nëse gjatë procedurës nuk vërtetohet se prona është tjetërsuar, që i bie që, ajo ka ardhur si rezultat i të hyrave të rregullta, që kanë qenë të raportuara dhe të taksuara, Administrata do të marrë një vendim për të vendosur një taksë, duke marrë për bazë për taksim dallimin në mes të hyrave të rregullta të raportuara dhe të taksuara të personit dhe të anëtarëve të familjes së tij dhe vlerës në treg të pronës. Baza e fiksuar në këtë mënyrë është e taksuar në një shkallë të përcaktuar sipas ligjit mbi taksën në të hyrat personale¹¹.

Një mosmarrëveshje administrative me kontest gjyqësor mund të iniciohet në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë kundër vendimit final për të vendosur taksën. Procedura në gjykatë është urgjente.

Ndaj zyrtarëve të sipërpërmendur, Komisioni Kombëtar mund të kërkoj të dhëna në lidhje me pronën e tij apo të familjes së tij, ndryshimet, aktivitetet që ushtrohen nga ai ose nga anëtarët e familjes së tij, të hyrat e realizuara, apo edhe të dhëna të tjera relevante për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Komisioni mund të kërkoj të dhënat e lartpërmendura edhe nga një organ kompetent apo person juridik dhe nëse kjo ndodh, atëherë organi apo personi juridik është i obliguar që pa vonesë të ofroj këto të dhëna dhe nuk mund të thirret në sekretet zyrtare, shtetërore apo të tjera.

d). Publikimi

Informatat nga pyetësi i anketimit mbi gjendjen e pasurisë, konsiderohen si informata të karakterit publik, përjashtuar informatat që mbrohen me ligj. Këto informata publikohen në faqen elektronike të komisionit kombëtar.

¹⁰ "Official Gazette of the Republic of Macedonia" No. 28 from April 26, 2002- LAW ON PREVENTION OF CORRUPTION, qasur me 10 prill 2010

¹¹ Law on Prevention of Corruption in Macedonia <http://www.dksk.org.mk/en/images/stories/law%20on%20prevention%20of%20corruption%20with%20amendments.pdf>, qasur me: 8 prill 2010.

5. Republika e Kosovës

5.1 Korniza Ligjore

Republika e Kosovës çështjen e deklarimit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik e ka të normuar me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 11.02.2010 dhe është shpallur me dekretin e Presidentit të Kosovës me 02.03.2010.

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik i nxjerrë nga institucionet e Republikës së Kosovës në esencë nuk ndryshon nga ligjet e vendeve tjera të rajonit të cilët e rregullojnë këtë fushë.

Ligji në fjalë parasheh disa lloje të deklarimit të pasurisë, duke u nisur nga: deklarimi i rregullt vjetor; deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik; deklarimi sipas kërkesë së Agjencisë si dhe deklarimin pas largimit nga funksioni.

Organi përgjegjës i cili administron dhe mirëmban regjistrin me të dhënat e deklaruara nga subjektet detyruese me Ligj është Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK).

a). Subjektet e detyruara për ta deklaruar pasurinë

Legjislacioni i Kosovës sa i përket numrit dhe kategorive të subjekteve që janë të obliguar që pasurinë e tyre ta bëjnë publike, nuk ndryshon nga praktika e shteteve që janë objekt i këtij hulumtimi, në përjashtim të Republikës së Maqedonisë e cila në legjislacionin e saj nuk e ka paraparë deklarimin e pasurisë për anëtarët e familjes – bashkëshorten dhe fëmijët.

Legjislacioni kosovar ka përcaktuar subjektet që hyjnë në përkufizimin e “Zyrtar i lartë publik” dhe të cilët janë të detyruar që ta deklarojnë pasurinë e tyre e ku bëjnë pjesë: Kryetari i Kosovës dhe gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Kryetari; Deputetët e Kuvendit të Kosovës; Kryeministri, zëvendës Kryeministri, Ministrat dhe zëvendës Ministrat në Qeverinë e Kosovës, si dhe gjithë të emëruarit nga ata; Udhëheqësit e sekretarive dhe zyrave tjera të Kryetarit të Kosovës, Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës; Sekretari i përhershëm i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, sekretari i përhershëm i Kuvendit, sekretari i përhershëm i kryeministrit, sekretarët e përhershëm të ministrive, drejtorët e departamenteve dhe pozitat e barasvlershme; Gjykatësit dhe Prokurorët; Drejtorët dhe anëtarët e bordit të kompanisë publike; Personat e akredituar jashtë vendit si përfaqësues të Kosovës; Udhëheqësit e agjencive, drejtorive, dhe institucioneve tjera të nivelit qendror të themeluar me ligj ose ndonjë akt tjetër; Kryetari dhe nënkryetarët e Komunave, kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit e kuvendeve komunale; Drejtori i administratës dhe i personelit të kuvendeve komunale; Auditorët e përgjithshëm dhe inspektorët e nivelit

qendror, Guvernatori dhe zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore; Ud-hëheqësit e bankave dhe institucioneve financiare me kapital publik; Rektori, Pro-Rektorët, dekanët dhe prodekanët e Universitetit Publik dhe sekretari i tij, si dhe sekretarët e njërive akademike dhe organizative të Universitetit Publik; të gjithë drejtorët dhe anëtarët e bordeve e të shoqërive aksionare me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror dhe publik më shumë se pesëdhjetë 50% (për qind); Zyrtarët e lartë që kryejnë funksione publike në strukturat e rendit, sigurisë dhe shërbimit doganor, si: komandanti, zëvendëskomandanti i FSK-së, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Doganës, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Agjencisë së Inteligjencës si dhe “Anëtarët e familjes” bashkëshortja dhe fëmijët e Zyrtarit të Lartë Publik¹².

Ligji në fjalë parasheh disa lloje të deklarimit të pasurisë, duke u nisur nga: deklarimi i rregullt vjetor; deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik; deklarimi sipas kërkesë së Agjencisë si dhe deklarimin pas largimit nga funksioni.

Bazuar në deklarimin e rregullt vjetor subjektet janë detyruar që gjenden e tyre të pasurisë ta deklarojnë në autoritetin përgjegjës – Agjensioni kundër Korrupsion deri më datën 31 mars të çdo viti.

Ligji po ashtu parasheh të drejtën e Agjencionit që të kërkojë nga subjektet e paraparë me ligj që të bëjnë publike të dhënat e tyre pasurore qoftë në momentin e marrjes së detyrës së zyrtarit të lartë publik (afati brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve), apo edhe pas përfundimit të punës në shërbimin publik (brenda tridhjetë (30) ditëve). Po ashtu Agjencisë i është garantuar kompetenca që në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik që ta dorëzojë informacionin.

b). Verifikimi i të dhënave të deklaruara

Çështja që ka të bëjë me verifikimin e të dhënave të deklaruara nga subjektet që i detyron Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, përkatësisht me nenin 8 autoritetit të Agjencisë i njihet e drejta që të urdhërojë kontrollin për saktësinë e deklarimeve të zyrtarit të lartë publik. Po ashtu Agjencioni ka kompetencë që të bëjë kontroll të plotë për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara në formular.

Megjithatë në krahasim me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë ku janë specifikuar qartë afatet kohore për verifikim të pasurisë së deklaruar, me legjislacionin e Republikës së Kosovës kjo çështje nuk është përcaktuar qartë.

¹² Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, <http://kuvendikosoves.org/?cid=1,122>, qasur me 10 prill 2010.

c). Sanksionet

Sa i përket sanksioneve që duhet të aplikohen nga ana e institucioneve kompetente ndaj subjekteve të cilët hezitojnë ta bëjnë deklarin e pasurisë apo në rastin më të keq edhe e bëjnë deklarin e rrejtshëm, ndryshon në secilin nga shtetet që janë objekt i këtij hulumtimi.

Derisa Republika e Shqipërisë ka masa më të ashpra ndaj zyrtarëve të cilët refuzojnë për deklarin duke i dënuar me humbjen e funksionit dhe ndëshkim me kodin penal, si dhe për deklarin të rremë duke i dënuar po ashtu në bazë të legjislacionit penal në këtë vend. Ndërsa sa i përket shkeljeve të detyrimeve të cilat nuk përbëjnë vepra penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Ndërsa Republika e Kroacisë për shkeljet e rënda ka paraparë që me kërkesën e Komisionit kompetent subjektet duhet të ofrojnë dorëheqjen tek organi që i ka emëruar, por nuk i ka specifikuar masat apo sanksionet ndëshkimore në rastet kur nuk e bëjnë këtë. Po ashtu kërkesa e Komisionit konsiston në rastet e shkeljeve të rënda por në ligj nuk janë specifikuar se çka nënkuptohet me shkelje të rënda. Sa i përket Republikës së Maqedonisë masat ndëshkimore janë paraparë vetëm të nivelit të përgjegjësisë për kundërvajtje dhe jo penale.

Në krahasim me vendet respektive Republika e Kosovës në asnjë rast nuk e ka paraparë kërkesën për largim nga puna të një personi për shkak të mos deklarin të pasurisë. Me legjislacionin aktual janë paraparë masa shumë të lehta ndëshkuese si kundërvajtje administrative të cilat dënohet me gjobë në vlerën më të lartë arrijnë deri në 1500 euro (për mos deklarin e pasurisë me kërkesën e Agjencisë) ndërsa shumat më të vogël ndëshkuese është 150 euro (për mos deklarin e pasurisë pas largimit nga funksioni dhe në rastet për mos deklarin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës).

Po ashtu me legjislacionin e Kosovës nuk është përcaktuar se në cilat raste sjelljet e zyrtarëve për mos deklarin të pasurisë paraqesin vepra penale të cilat do të duhej të sanksionoheshin sipas legjislacionit penal në vend, megjithatë neni 19 i Ligjit për Deklarin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë i ka dhënë të drejtë Gjykatës kompetente të rishikoj nëse informacioni i siguruar në deklarinet që mbahen në regjistër është i saktë, i vërtetë dhe i plotë, ku më pas do të mund të kërkoj bashkëpunim nga organet relevante qeveritare, autoritetet e qeverisjes lokale, personat tjerë juridik dhe fizik, si dhe të kërkoj nga këto subjekte informacione, shpjegime dhe konfirmime të nevojshme për të vendosur se informatat që gjenden në regjistër, korrespondojnë me faktet dhe provat.

d). Publikimi

Pasqyrat me të dhënat e deklaruara mbi gjendjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, në të katër shtetet ku është koncentruar ky studim: Kroaci, Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, janë publike dhe të qasshme për publikun.

6. Përfundime

Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik mund të krijoj motivimin e duhur për të ndryshuar sjelljet dhe praktikatat që promovojnë transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në një vend aspirues për të ndërtuar një sistem demokratik të funksionimit të shtetit.

Demokracitë e vendeve në tranzicion tentojnë vazhdimisht që të krijojnë bazë ligjore për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik si masë preventive për luftë kundër korrupsionit dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike. Sidoqoftë, vetëm baza ligjore nuk është gjithmonë e mjaftueshme sepse ligjet shpesh mund të jenë shumë konfuze ose mungon vullneti për zbatimin e tyre. Megjithatë mbikëqyrja publike nga qytetarët, shoqëria civile dhe mediat duhet të kompletojnë kontrollin e shtetit, e në mënyrë që të dyja këto të funksionojnë, duhet të ekzistoj transparenca.

Legjislacioni që rregullon bërjen publike të financave të zyrtarëve publik të zgjedhur, në shtetet që është përqendruar ky studim, mes tyre ka një dallim të vogël i cili vërehet sidomos në vendet që janë më afër aderimit në Bashkimin Evropian në krahasim me ato që më tepër janë aspiruese sesa janë realisht afër këtij procesi.

Dallimi më esencial ekziston tek masat sanksionuese ndaj personave që refuzojnë ta bëjnë deklarimin e pasurisë. Republika e Shqipërisë ka masa më të ashpra ndaj zyrtarëve të cilët refuzojnë për deklarim duke i dënuar me humbjen e funksionit dhe ndëshkim me kodin penal, si dhe për deklarim të rremë duke i dënuar po ashtu në bazë të legjislacionit penal në këtë vend. Legjislacioni i Republikës së Kroacisë ka paraparë që për shkeljet e rënda me kërkesën e Komisionit kompetent subjektet duhet të ofrojnë dorëheqjen tek organi që i ka emëruar, por nuk i ka specifikuar se çka në të vërtet mund të konsiderohet si shkelje e rëndë. Ndërsa legjislacioni i Republikës së Maqedonisë ka paraparë vetëm përgjegjësi për kundërvajtje dhe jo penale. Kurse legjislacioni i Republikës së Kosovës në krahasim me vendet tjera edhe pse është shumë larg procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, ka paraparë masa shumë të lehta ndëshkuese si kundërvajtje administrative duke përjashtuar kërkesën për largim nga puna të një personi që nuk pranon ta deklaroj pasurinë si dhe nuk ka përcaktuar se në cilat raste sjelljet e zyrtarëve për mos deklarim të pasurisë paraqesin vepra penale dhe do të duhej të përgjigjeshin në pajtim legjislacionit penal në vend.

Kosova në krahasim me vendet e rajonit është vendi i cili i fundit e ka rregulluar këtë materie me ligj duke e miratuar ligjin përkatës me 11.02.2010 nga Kuvendi i Kosovës.

Praktika e vendeve të rajonit ka treguar efekte pozitive gjatë procesit të implementimit të legjislacionit që rregullon këtë fushë, ndërsa sa i përket Republikës së Kosovës një gjë e tillë mbetet të shihet gjatë procesit të zbatimit të ligjit në praktikë.

Bibliografia

Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të detyrime Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë.

<http://www.hidaa.gov.al/legjislacioni.html>, qasur me 07 prill 2010.

“Official Gazette of the Republic of Macedonia” No. 28 from April 26, 2002- LAW ON PREVENTION OF CORRUPTION

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë.

<http://kuvendikosoves.org/?cid=1,122>, qasur me :10 prill 2010.

Zakon o sprječavanju sukoba interesa u obnašanju javnih dužnost (Croatia).

<http://lokalniizbori.com/zakoni/zakon-o-sprjecavanju-sukoba-interesa-u-obnasanju-javnih-duznosti/>, qasur me: 06 prill 2010.

Law on Prevention of Corruption in Macedonia

<http://www.dsk.org.mk/en/images/stories/law%20on%20prevention%20of%20corruption%20with%20amendments.pdf>, qasur me: 06 prill 2010.

Law on Prevention of Conflict of Interest in Macedonia

http://www.dsk.org.mk/en/images/stories/PDF/law/law_on_prevention_of_conflict%20of_interests.pdf, qasur me 06 prill 2010.

Ordinance for the proclamation of the law on changes and additions to the law on prevention of conflict of interest (Macedonia)

<http://www.dsk.org.mk/images/stories/pdf/amendments%20to%20the%20law%20on%20prevention%20of%20conflict%20of%20interests.pdf>, qasur me: 06 prill 2010.



Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute

www.kdi-kosova.org

Comparative analyse

**The legislation for Disclosure, Origin and Control
